



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV), ishte nënvlerësuar për 870,760€, ndërsa e pasurive jo kapitale për 56,315€, si rezultat i mos regjistrimit dhe mos shpalosjes së pasurive;
- B2 MKRS gjatë vitit 2024, kishte ekzekutuar pagesa në kategori jo adekuate në vlerë prej 662,412€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Gjatë testimit të procedurave të rekrutimit kemi vërejtur se në dy raste nuk ishin respektuar kërkesat ligjore.
- A2 MKRS në kundërshtim me kufizimet buxhetore të vendosura në vendimin për thirrje publike, kishte tejkaluar buxhetin e planifikuar me rastin e vlerësimit të projekteve si dhe kishte subvencionuar institucione tjera të paplanifikuara me buxhet.
- A3 Në 11 raste kemi vërejtur se pozitat e rregullta të punës mbaheshin me ushtrues detyre më gjatë se afati i paraparë ligjor.
- B3 Në dy (2) raste në vlerë prej 833,595€ nuk ishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve siç përcaktohet me marrëveshje.
- B4 Në tetë (8) raste, faturat në vlerë prej 165,052€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin nga 11 deri 179 ditë kalendarike.
- B5 MKRS, në fund të vitit 2024 kishte avance të paarsyetuara për udhëtime zyrtare në vlerë prej 40,984€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i MKRS është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i MKRS është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2024, ka shpenzuar 75% të buxhetit final, duke shënuar një zvogëlim prej 3% krahasuar me vitin 2023. Fushat me problemet më të theksuara kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë dhe klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet mangësive në procest e rekrutimit, respektimit të afateve ligjore të përcaktuara me ligj për ushtrues detyre, procesit të dhënies dhe menaxhimit të subvencioneve, vonesave në mbyllje të avanceve dhe vonesave në pagesën e faturave.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësimit të kontroleve të brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Po ashtu, ne si ekip kemi dhënë këshilla për përmirësimin e draft pasqyrave financiare vjetore të MKRS për vitin 2024, të cilat pas rekomandimeve tona, janë përmirësuar.

Ky raport ka rezultuar me 17 rekomandime, prej tyre 10 janë rekomandime të reja dhe shtatë (7) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurive dhe prezantimi jo i plotë i tyre në PVF

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Po ashtu, neni 6 i Rregullores Nr. 01/2027 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, citon: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Vlera e pasurive kapitale të prezantuar në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV), ishte nënvlerësuar për 927,075€, për shkak të mangësive në regjistrimin e pasurive, si:

- Në gjashtë (6) raste, pasuria në vlerë prej 870,760€ nuk ishte regjistruar në SIMFK; dhe
- Në një rast, pasuria në vlerë prej 56,315€ nuk ishte regjistruar në sistemin e e-pasurisë.

Mangësitë e identifikuar kishin ardhur si shkak i mungesës së komunikimit të duhur mes njësive brenda MKRS-së.

Ndikimi Mos regjistrimi i plotë i pasurive në regjistrat përkatës, ndikon në paraqitjen jo të drejtë dhe të saktë të pasurive në PFV. Po ashtu, pasuritë e paregjistruara mund t'i ekspozohen rrezikut të humbjes dhe tjetërsimit.

Rekomandimi B1 Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë se, aplikohet regjistrimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale me qëllim të ruajtjes së pasurisë dhe paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18, pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që Organizatat Buxhetore (OB) duhet të i aplikojnë.

MKRS gjatë vitit 2024, kishte ekzekutuar pagesa në kategori ekonomike jo adekuate, në vlerë prej 662,412€ si:

- Pagesa në vlerë 631,066€ e paguar përmes vendimeve gjyqësore për "Shpenzime të organizimit të eventeve, dizajne dhe shtypja e materialeve promovuese" ishte ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale, derisa shpenzimi përkatës për nga natyra i takonte kategorisë së mallrave dhe shërbimeve;
- Pagesat në vlerë 395,596€ të ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore për Investime Kapitale, si pjesë e shpenzimeve shpesh dhe përmbartimore, përfshinte një vlerë prej 12,996€, që për nga natyra i takonin kategorisë Mallra dhe Shërbime.
- Tek kontrata për "Furnizim me pajisje pune dhe materiale të nevojshme për restaurim - konservimin e artefakteve dhe kabineteve për Muzeun Kombëtar të Kosovës, pagesa për pajisje në vlerë 18,350€ e paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, për nga natyra i takonte kategorisë së investimeve kapitale.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i planifikimit jo të duhur ekonomik dhe si rezultat i ekzekutimit të pagesave nga Thesari për pagesat e vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate ekonomike kanë ndikuar në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke shkaktuar mbivlerësim/nënvlerësim të kategorisë së investimeve kapitale si dhe kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në

përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në proceset e rekrutimit

Gjetja

Sipas nenit 44 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përcakton që "Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë". Ndërsa neni 7, paragrafi 2. i Rregullores (QRK) nr.05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës përcakton se: "Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe jo më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike". Po ashtu Neni 13 verifikimi paraprak paragrafi 5 Përcakton se "Kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për aplikim, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin".

Gjatë testimit të procedurave të rekrutimit kemi vërejtur dobësi në proces si në vijim:

- Në BKK kemi vërejtur se një zyrtar, i cili që nga viti 2012 kishte ushtruar pozitën Udhëheqës i sektorit të TI-së, ishte emëruar në pozitën Udhëheqës i Divizionit të TI-së (Drejtues i ulët), me datë 20.12.2024, pa ndjekur një procedurë të hapur të rekrutimit, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.
- ASHAK më datë 06.12.2023 kishte shpallur konkurs për pozitën Receptionist, ndërsa afati për dorëzimin e aplikacioneve ishte caktuar deri më 09.01.2024, duke tejkaluar kështu afatin ligjor prej 15 ditësh për dorëzimin e aplikacioneve, siç parashihet me legjislacionin përkatës. Për më tepër, kandidati i përzgjedhur nuk i kishte plotësuar kriteret e përcaktuara në konkurs, e të cilat nuk ishin konform kërkesave të rregullores për këtë pozitë, konkretisht kriterin për tre (3) vite përvojë pune, pasi kishte ofruar dëshmi vetëm për 16 muaj përvojë. Për më tepër, marrëdhënia e punës duhet të lidhet me kontratë pune, e jo me akt emërim.

Këto kishin ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm dhe mosrespektimi i rregulloreve dhe ligjeve në fuqi.

Ndikimi

Dobësitë në procese të rekrutimit duke emëruar zyrtarë në pozita drejtuese pa iniciuar konkurs të hapur dhe publik, si dhe duke mos respektuar kriteret dhe afatet e përcaktuara ligjore ka ndikim negativ në transparencën dhe besueshmërinë e procesit të rekrutimit.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të siguroj që të gjitha proceset e rekrutimit bëhen në përputhje me rregullat dhe ligjet e përcaktuara, duke iniciuar konkurse të hapura dhe publike për çdo pozitë të lirë. Është thelbësore që të respektohen kriteret dhe procedurat e rekrutimit për të garantuar transparencë dhe barazi në proceset e punësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Tejkalmi i buxhetit të planifikuar dhe subvencionim i paplanifikuar**Gjetja**

Sipas vendimit të datës 13.03.2024 për thirrjen publike për projekt - propozimet në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë për vitin 2024, pika 2 mbështetja financiare për projektet e OJQ-ve dhe Individëve do të ofrohet nga Buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe sportit / Departamenti i kulturës në vlerë 2,000,000€ për projektet në fushën e artit dhe kulturës, ndërsa 400,000€ nga departamenti i trashëgimisë për projektet në fushën e trashëgimisë kulturore. Më tutje, Rregullorja MF-Nr -04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe Rregullorja Nr. 09/2015 për subvencionimin në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sporteve nuk parashohin financim për institucione publike.

Gjatë testimit, kemi vërejtur që MKRS në kundërshtim me kufizimet buxhetore të vendosura në vendimin për thirrje publike, kishte tejkaluar buxhetin e planifikuar me rastin e vlerësimit të projekteve si dhe kishte subvencionuar institucione tjera të paplanifikuara me buxhet:

- Nga departamenti i kulturës ishin përkrahur projekte në vlerë 4,104,229€, ndërsa nga departamenti i trashëgimisë kulturore projekte në vlerë 840,801€, duke tejkaluar buxhetin e planifikuar mbi 100% bazuar në thirrjen publike.
- MKRS ka subvencionuar Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) në vlerë 140,000 € për transmetimin e ndeshjeve të kombëtares së futbollit, pavarësisht se RTK është një medium publik dhe si i tillë financohet nga Kuvendi i Kosovës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Tejkalmi i buxhetit të planifikuar me thirrje publike për subvencionim si dhe mënyra e financimit ndaj RTK-së rrit rrezikun e hyrjes në obligime pa buxhet, mund të ndikojë në vlerësim jo profesional të projekteve dhe të përkrahen projekte që nuk janë në përputhje me objektivat e përcaktuara.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë që buxheti i planifikuar për subvencionim të jetë në përputhje me kufizimet buxhetore dhe që financimet tjera të realizohet në mënyrë transparente dhe të justifikueshme, duke shmangur obligimet pa buxhet dhe duke siguruar që projektet e përkrahura të jenë në përputhje me objektivat e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Tejkalmi i afateve të parapara ligjore si ushtrues i detyrës**Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik, neni 35 paragrafi 3 përcaktohet se: Zyrarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.

Ministria kishte të caktuar me Vendim 49 zyrtarë ushtrues detyre, prej të cilëve:

- 28 raste në MKRS;
- 14 raste në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës (BKK) dhe
- Shtatë (7) raste në Arkivin Shtetëror të Arkivave të Kosovës (ASHAK).

Po ashtu, në 11 raste kemi vërejtur se pozitat e rregullta të punës mbaheshin me ushtrues detyre më gjatë se afati i paraparë ligjor prej dymbëdhjetë (12) muaj si në vijim:

- Shtatë (7) në Ministri;
- Një (1) në ASHAK;
- Dy (2) në BKK; dhe
- Një (1) në AMMKM.

Kjo situatë ishte shkaktuar nga vonesat në kompletimin e rregulloreve për organizim dhe sistematizim e vendeve të punës në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndikimi

Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor rrezikon që pozitat e ndryshme të mbahen nga persona që nuk i përmbushin kriteret e kërkuara/përcaktuara për pozitat adekuate.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të siguroj respektimin e afateve ligjore të përcaktuara me ligj për ushtrues detyre, finalizimin e legjislacionit të brendshëm me qëllim të plotësimit të pozitave me staf të rregullt të punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesat në arsyetimin e subvencioneve

Gjetja

Ministria me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të kulturës në përgjithësi, përveç tjerash, bënë edhe subvencionimin e projekteve të ndryshme kulturore dhe sportive, qoftë të entiteteve publike apo atyre jo publike. Subvencionet jepen në formë të avanceve me qëllim që të njëjtat të arsyetohen sipas marrëveshjeve të nënshkruara kryesisht në fund vit, ndërsa bartësit e projekteve obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e realizuara në bazë të afateve të parapara me kontrata.

Në dy (2) raste të testuara, në vlerë totale prej 833,595€ përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara, të cilat sipas marrëveshjeve do të duhej të ishin mbyllur. Si rezultat ato figurojnë ende të hapura. Këto raste janë si në vijim:

- Federata e khudo-së në vlerë 533,595€;
- Federata e Hendbollit në vlerë 300,000€.

Kjo ishte si pasojë e mos funksionimit të duhur të sistemit të monitorimit të shpenzimeve të federatave nga MKRS, dhe si pasojë e mungesës së mekanizmave adekuat që do t'i kushtëzonte përfituesit që të raportojnë për projektet e subvencionuara.

Ndikimi

Mos arsyetimi dhe raportimi për projektet e subvencionuara nga përfituesit e subvencioneve sipas fateve të përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara, bën të pamundur konfirmimin nëse objektivat e ministrisë dhe vlera për para është arritur. Njëherit mund të dëmtojë buxhetin e ministrisë dhe rrit mundësinë e përdorimit të fondeve për qëllime tjera.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara arsyetohen në kohën e paraparë dhe të jenë konform kërkesave të memorandumit, mbështetur me dokumente valide të parapara me rregulloren për subvencione dhe transfere. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e obligimeve të papaguara

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, "Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës".

Në tetë (8) raste, faturat në vlerë prej 165,052€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat variojnë nga 11 deri 179 ditë kalendrike.

Vonesat ishin të shkaktuara nga mungesa e mjeteve buxhetore dhe planifikimi jo i mirë për kryerjen e obligimeve sipas afateve të përcaktuara.

Ndikimi

Vonesat në pagesa ndaj furnitorëve rrisin rrezikun që në periudhat e ardhshme ministria të ballafaqohet me padi gjyqësore/përmbartimore të cilat njëherit rezultojnë me shpenzime shtesë duke e rënduar buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B4

Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat të procedohen me kohë për pagesë sipas afatit të përcaktuar ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa në mbylljen e avanceve për udhëtime zyrtare**Gjetja**

Sipas UA Nr. 2004/07 - për Udhëtimet Zyrtare neni 8 si dhe nenin 9, paragrafi 1 i Rregullores (QRK) Nr.06/2023 për Kompenzimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit përcakton "Kërkesa për kompensim dhe shpenzime të vogla së bashku me të gjitha dëshmitë për shpenzimet financiare i dorëzohet njësisë përkatëse për buxhet dhe financa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar". Po ashtu, Neni 10, paragrafi 4 përcakton "Në rast kur zyrtari nuk kthen shumën, ajo do të ndalohet sipas sistemit të pagave".

MKRS, në nenin 20 të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) kishte raportuar avance të paarsyetuara për udhëtime zyrtare në vlerë prej 40,984€. Nga kjo shumë, vlera prej 19,590€ ishin avance të pambyllura nga vitet paraprake (2010-2023), përderisa avance të pambyllura për vitin 2024 ishin në vlerë prej 21,394€, të cilat kishin kaluar afatin ligjor prej 15 ditëve.

Kjo gjendje ka rezultuar si pasojë e mungesës së veprimeve të duhura ligjore nga ana e ministrisë për kthimin e mjeteve nga zyrtarët përkatës.

Ndikimi

Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve zyrtare dhe mos mbyllja e avanceve brenda afatit ligjor, rritë rrezikun që paratë të jenë përdorur në kundërshtim me qëllimet e synuara, rregullat e aplikueshme apo keqpërdorim të mjeteve publike.

Rekomandimi B5

Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2024 ishte 6,733,377€, nga i cili janë realizuar shpenzime në vlerë 6,702,027€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 816 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 725.

Çështja A4 - Mos nxjerrja e rregulloreve të brendshme në përputhje me dispozitat ligjore

Gjetja	Neni 34, i Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil përcakton se: "Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje. MKRS dhe Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMMKM) kishin hartuar draft rregullore përkatëse, por ato ende nuk ishin finalizuar. Ndërsa Biblioteka Kombëtare e Kosovës ende nuk kishte hartuar rregulloren e saj, ndonëse kjo është e kërkuar me legjislacionin në fuqi. Ndryshimet e fundit ligjore që prekin sektorët e MKRS-së, si në fushat e rinisë dhe sportit, kanë krijuar nevojën për rishikimin e disa aspekteve të rregulloreve, duke çuar në vonesa të miratimit të tyre.
Ndikimi	Mos finalizimi i rregulloreve për klasifikimin dhe grupimin të pozitave të punës në përputhje me dispozitat ligjore mund të krijoj vonesa në realizimin e kërkesave të parashikuara nga kjo rregullore. Këto vonesa mund të ndikojnë në funksionimin e duhur të institucioneve përkatëse dhe zbatimin e politikave në përputhje me ndryshimet ligjore, duke krijuar pasiguri në menaxhimin dhe zbatimin e proceseve administrative.
Rekomandimi A4	Ministri duhet të siguroj që të përshpejtohet procesi i hartimit dhe miratimit të rregulloreve, duke siguruar koordinim të ngushtë mes institucioneve dhe respektimin e afateve të përcaktuara sipas rregulloreve në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2024 ishte 25,356,341€, prej tyre ishin shpenzuar 23,084,508€. Shpenzimet për mallra dhe shërbime, kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, mirëmbajtje, pajisje të IT-së, derivate, shpenzime të qirasë, shërbime kontraktuese, shërbime komunale etj.

Çështja A5 - Angazhimi i konsulentëve përmes procedurave të prokurimit për mbulimin e pozitave të rregullta

Gjetja

Sipas Rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (Konsulentët/Kontraktorët individual), neni 3.1 përcakton se këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilët nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06-L-114. Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbimet profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktuese ka nevojë por që nuk i plotëson kërkesat me stafin që e ka. Më tej, neni 3.2 përcakton se Konsulenti /Kontraktori individual është një specialist në një fushë specifike, i angazhuar nga Autoriteti Kontraktues në rolin e një këshilluesi.

Gjatë vitit 2024, MKRS (përfshirë institucionet vartëse) kishte të angazhuar 153 konsulentë me marrëveshje për shërbime të veçanta përmes procedurave të prokurimit, si:

- 149 në MKRS;
- Tre (3) në AMKMK; dhe
- Një (1) në BKK.

Këta persona ishin angazhuar në pozita të rregullta, si zyrtar: administrativ, ligjor, i financave, arkivit, IT, vozitës, historian, etnologue, etj.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve jo të duhura dhe mos aplikimit të drejtë të kërkesave ligjore.

Ndikimi

Angazhimi i personelit për pozita të rregullta me kontrata për shërbime të veçanta përmes procedurave të prokurimit, ndikon në mos pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe në përzgjedhjen e stafit me përvojë dhe kualifikime jo adekuate për pozita të caktuara.

Rekomandimi A5

Ministri duhet të siguroj që pozitave të rregullta të punës të përfshihen në planin e rekrutimeve dhe rekrutimi i tyre të bëhet përmes procedurave të rregullta të rekrutimit në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Tejkalmi i vlerës së kontratës

Gjetja

Neni 1, paragrafi 1.4 i kontratës përcakton që kontrata hyn në fuqi me 16.10.2023 dhe përfundon me 15.10.2026. Po ashtu, sipas kontratës, neni 4, çmimi i total i ofertës do të jetë në vlerë financiare 800,000€ (+/-30%).

Nga auditimi i pagesave për kontratën kornizë "Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e MKRS-së" e nënshkruar më datë 16.10.2023 në vlerë 800,000€ (+/- 30%), kemi vërejtur

se MKRS kishte realizuar pagesa në vlerë 1,062,093€. Pra vlera e pagesave kishte tejkaluar vlerën e kontratës perfshirë (+30%) për 22,093€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme gjatë realizimit të kontratës kornizë.

Ndikimi Mungesa e kontrolleve efektive në menaxhimin e kontratës, duke pranuar shërbime/furnizime përtej limiteve të lejuara me kontratë, ndikon në realizimin e pagesave jo sipas kontratës, shpenzime të paplanifikuara dhe kufizimi të financimit të projekteve tjera, duke ndikuar po ashtu në transparencën lidhur me shpenzimin e fondeve publike.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e kontratave kornizë, duke siguruar që shpenzimet të jenë në përputhje vlerat e kontraktuara, me qëllim të shmangjes së tejkallimeve buxhetore dhe përdorimit efikas të buxhetit të saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E-prokurimit

Gjetja Sipas nenit 70, paragrafi 70.24.f. i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik përcakton që: “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Gjatë testimit të shtatë (7) kontratave në vlerë 1,661,385€, vërejtëm që menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në mos përmbushjen e kërkesave ligjore si dhe pamundësinë që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të sigurojë që të gjithë menaxherët e projekteve, aplikojnë menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektronik të prokurimit publik, me qëllim të mbikëqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti apo përdoruesit tjerë të mundshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mungesa e njoftimit paraprak

Gjetja Neni 6, paragrafi 6.2 i Rregullores për Prokurim publik përcakton: “ Nëse AK ka qëllim të dhënies së kontratave gjatë periudhës së ardhshme prej 12 muaj, të një ose më shumë kontratave për furnizime, shërbime ose punë të cilat kanë një vlerë të parashikuar, prej 500,000€ ose më shumë, afati kohorë i përgatitjes së njoftimit indikativ nga zyrtari i prokurimit është: a. në rast të Njoftimit Paraprak për furnizime ose shërbime sa më shpejtë që është e mundshme pas fillimit të vitit fiskal.

Ministria me datë 23.12.2024 kishte lidhur kontratën "Shërbime të prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e MKRS dhe institucioneve vartëse", në vlerë 1,500,000€. Megjithatë, MKRS nuk kishte përgatitur dhe publikuar njoftimin paraprak në fillim të vitit siç kërkohet me rregullore.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Mungesa e njoftimit paraprak ndikon në mos përmbushjen e rregullave të prokurimit publik dhe njëkohësisht e ulë edhe transparencën për OE që të njoftohen dhe përgatiten në kohë reale për prokurimet e mundshme.

Rekomandimi A8

Ministri duhet të siguroj që njoftimi paraprak të përgatitet dhe publikohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren për Prokurim Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Planifikim jo i mirë dhe vonesë në pranimin e mallit

Gjetja

Sipas nenit 2, paragrafit 2.1 të kontratës, kushtet e dërgesës si dhe nenit 11, programi i ekzekutimit të kushtet e veçanta përcakton afatet kohore për dorëzim të mallit.

Gjatë testimit në tri (3) raste të kontratave në MKRS, kemi vërejtur se nuk ishin respektuar afatet/kushtet e përcaktuara me kontratë, si:

- BKK kishte lidhur kontratën (mini-tender) "Shtypja e materialeve të ndryshme për nevojat e BKK-së me rastin e 80 - vjetorit të Bibliotekës" në vlerë 5,282€ me datën 20.11.2024. Sipas fletëdërgesës, komisioni i pranimit kishte bërë pranimin e furnizimeve më 09.12.2024, pas përfundimit të kontratës.
- Ministria kishte lidhur kontratën në vlerë 12,600€, të ndarë në dy Lote më 28.07.2023. Gjatë testimit të pagesës për Lot 2, në vlerë 3,598€, për "Furnizim me tepihë për nevojat e MKRS-së", është vërejtur se OE kishte dorëzuar furnizimin sipas kushteve të kontratës. Megjithatë, Ministria ka kërkuar ndërrimin e mostrës, gjë që nuk ka qenë e mundur për OE. Për më tepër, nga tre (3) mostra të ofruara nga OE, ministria kishte përzgjedhur një të tepihut duke plotësuar vetëm njërin nga pozicionet e Lot 2, ndërsa pozicioni tjetër nuk është realizuar fare.
- Kontrata për "Pajisje me programin Archicad 26 për MKRS dhe institucionet vartëse" në vlerë 92,942€, e nënshkruar me datën 11.07.2023, nuk kishte përfunduar në tërësi, konkretisht pjesa e trajnimit të stafit në vlerë 5,124€ (deri në kohën e përfundimit të auditimit 11.03.2025).

Arsyet e mangësive gjatë realizimit të kontratave ishin planifikimi jo i mirë, mos zbatimi i afateve të kontratës si dhe pa mundësia e ndërhyrjeve të ASHI-së në antivirusin e instaluar në kompjuterë të institucioneve.

Ndikimi

Mos përmbushja e kontratës me kohë nga ana e OE mund të shkaktoj vonesa në implementimin e aktiviteteve që janë paraparë të ndodhin. Po ashtu, kërkesat shtesë dhe ndryshimet e furnizimeve nga ana e ministrisë rrisin rrezikun e humbjes financiare pasi që e njëjta mund të jetë e detyrues.

të paguajë kosto shtesë për OE.

Rekomandimi B6

Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme për të parandaluar vonesat dhe mosrespektimin e afateve, duke planifikuar më mirë procesin e furnizimit dhe trajnimeve, dhe duke siguruar që operatorët ekonomikë të respektojnë afatet dhe kushtet e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 25,356,341€, prej tyre ishin shpenzuar 23,084,508€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

Çështja A9 - Formimi i komisionit vlerësues dhe i ankesave për subvencionet jo në përputhje me kërkesat ligjore

Gjetja

Rregullorja MF-Nr -04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 8 - Komisioni i Vlerësues, përcakton: Komisioni Vlerësues përbëhet nga pesë (5) anëtar, si në vijim: 1. një përfaqësues nga njësia përkatëse, në kuadër të të cilës është planifikuar. 2. dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, të cilët do të zgjidhen përmes një thirrje publike të cilën do ta bëjë ofruesi i mbështetjes financiare; 3. dy përfaqësues nga institucioni që ofron mbështetjen financiare, njëri nga të cilët duhet të jetë nga njësia përkatëse për buxhet/financa. 4. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit Vlerësues nga paragrafi 3 i këtij neni, ofruesi i mbështetjes financiare duhet të parasheh me vendim edhe një (1) anëtarë rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi.

Tutje, neni 9 - Komisioni i ankesave, përcakton që: Në Komisionin Ankesave nuk mund të marrin pjesë anëtarët të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e aplikacionit në kuadër të Komisionit Vlerësues dhe të emëruarit politik.

Gjatë testimit të procesit të dhënie së subvencioneve kemi vërejtur dobësi në formimin e komisionit të vlerësimit dhe atij të ankesave si:

- Komisioni për vlerësimin e projekteve ishte formuar në kundërshtim me rregulloren pasi që në komision nuk ishte caktuar asnjë anëtar nga njësia përkatëse - departamenti i kulturës e as nga departamenti i financave (përveç një anëtarë rezervë).
- Ndërsa për thirrjen publike "Fondi i Mobilitetit 2024, Sport- Rini-Art, Kulturë-Trashëgimi Kulturore" me vendime të ndara, fillimisht me datë 13.05.2024 ishte formuar komisioni për vlerësimin e aplikacioneve, ndërsa me datën 14.06.2024 ishte formuar komisioni i ankesave. Mirëpo në këto vendime ishte caktuar i njëjti zyrtar nga departamenti i sportit, si anëtar në të dy komisionet.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve jo të duhura gjatë formimit të komisioneve.

Ndikimi

Formimin i komisionit të vlerësimit dhe komisionit të ankesave në kundërshtim me rregulloren mund të çojë në konflikt interesi dhe mungesë transparence, duke rrezikuar ligjshmërinë e procesit dhe besueshmërinë e tij.

Rekomandimi A9

Ministri duhet të sigurojë që komisionet për vlerësimin dhe ankesa të formohen në përputhje me rregulloren dhe të përfshijnë anëtarë nga të gjithë departamentet përkatëse, për të siguruar paanshmërinë, transparencën dhe respektimin e procedurave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 43,131,166€, prej tyre ishin shpenzuar 26,172,158€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me renovimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore, ndërtimin e palestrave sportive, qendrave kulturore, rinore etj.

Çështja B7 - Vonesat në realizimin e punimeve

Gjetja

Sipas neneve 61.6, 61.19 dhe 61.20 të Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, përcaktojnë se: Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Për më tepër, secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Gjatë auditimit, në dy (2) raste kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas afatit kohor të përcaktuar me kontratë dhe atë si në vijim:

- MKRS kishte nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Komunën e Suharekës më datë 30.07.2020 për bashkëfinancimin e projektit “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi - Suharekë”. Kontrata për zbatimin e këtij projekti në vlerë 2,712,712€ ishte lidhur nga Komuna më 15.08.2023. Sipas pikës 17.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) afati i përfundimit të punëve ishte 75 ditë kalendarike, përkatësisht deri më 13.11.2023. Përkundër saj, projekti kishte përfunduar më 20.12.2024, me vonesë rreth 490 ditë pune.
- AMMKM kishte nënshkruar kontratën për projektin “Konservimi dhe Ndërtimi i kompleksit memorial - Historik- Shtabi i ZOD-it të UÇK-së dhe Muzeut në Glllogjan, Faza e III-të - Ritender” vlerë 2,314,764€, më datë 24.10.2024. Afati për përfundimin e projektit ishte caktuar më 31.12.2024, por deri në fund të vitit ishin realizuar dhe paguar vetëm rreth 50% e punimeve, ndërsa projekti mbeti i papërfunduar.

Sipas arsyetimeve të dhëna nga menaxherët e kontratave, shkaqet e vonesave janë kryesisht kushtet atmosferike, zgjatja e procedurave për aprovimin e punëve shtesë si dhe punët e pa planifikuara.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore në vitet vijuese, po ashtu ndikon në mos arritjen e objektivave të përcaktuara të ministrisë.

Rekomandimi B7

Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave të kontratave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta për Investime kapitale si dhe mallra dhe shërbime.

Çështja A10 - Mangësi në përcaktimin e specifikave teknike

Gjetja

Referuar nenit 28, paragrafi 7 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës "Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent".

Nga mostrat e testuar kemi vërejtur se në dy (2) raste, me rastin e përgatitjes së specifikimeve teknike ishin përdorur specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, por nuk ishin shoqëruar nga shprehjet ose fjalët "ekuivalent" siç kërkohet me ligj. Këto janë vërejtur si në vijim:

- Kontrata për "Punët ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm të arkitekturës dhe inxhinierisë për zgjerimin dhe renovimin e Stadiumit të Qytetit në Shtime - Ri tenderim", n; specifikacionin e tenderit ishte kërkuar radiatora të çelikut të "Fabrikës së Radiatorëve" Gjilan; dhe
- Kontrata për "Furnizim me pajisje pune dhe materiale të nevojshme për restaurim - konservimin e artefakteve dhe kabineteve për Muzeun Kombëtar të Kosovës Ritenderim i dytë", ishte kërkuar në specifikacion, pozicioni thithëse (fshesë) pluhuri për pastrim sipërfaqësor të artefakteve me prodhues Bosch.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike nga njësitë kërkuuese.

Ndikimi

Mos përfshirja e shprehjes "ose ekuivalent" në specifikimet teknike kufizon konkurrencën mes operatorëve ekonomikë dhe rrit rrezikun e favorizimit të operatorëve të caktuar. Kjo mund të rezultojë në oferta më pak konkurruese dhe çmime më të larta për ministrinë.

Rekomandimi A10

Ministri duhet që të rris nivelin e kontrollit dhe llogaridhënies që njësitë kërkuuese, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, të përfshijnë patjetër shprehjen "ose ekuivalent" kur përmenden emërtime apo produkte specifike, në mënyrë që të respektohen kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	88,118,721	82,989,100	62,249,462	46,211,509	25,103,236
Grante Qeveritare - Buxheti	88,001,131	82,629,451	62,108,869	46,078,554	24,930,327
Të bartura nga viti i kaluar	0	29,587	11,652	4,828	10,456
Të hyrat vetanake	117,590	117,590	8,250	23,178	6,065
Donacionet vendore	0	18,898	0	10,000	0
Donacionet e jashtme	0	193,575	120,691	94,949	156,388

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 5,129,621€, kryesisht si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore.

Në vitin 2024, MKRS ka shpenzuar 75% të buxhetit final, ose 62,249,462€, me një rënie prej 3% krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	88,118,721	82,989,100	62,249,462	46,211,509	25,103,236
Pagat dhe mëditjet	6,958,236	6,733,377	6,702,027	6,226,003	4,880,533
Mallrat dhe shërbimet	5,120,027	7,267,784	5,993,349	4,553,493	3,152,252
Komunalitë	483,908	500,433	297,419	394,313	264,618
Subvencionet dhe transferet	17,116,550	25,356,341	23,084,508	22,037,975	13,021,111
Investimet Kapitale	58,440,000	43,131,166	26,172,158	12,999,725	3,784,720


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 224,859€. Ky zvogëlim fillimisht ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë për shkurtime buxhetore në vlerën prej 319,536€, pastaj kishte rritje nga ndarja e granteve të donatorëve në vlerë 94,677€. Realizimi për këtë kategori ishte 99.5% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 2,147,757€. Rritja ishte ndikuar nga lëvizjet buxhetore sipas vendimeve për transfere në mes në kategorive ekonomike në vlerë 2,016,463€, të hyrat vetanake të bartura në vlerë 29,587€, si dhe ndarjet nga grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë 101,707€. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 82.5%;
- Buxheti final për shpenzimet komunale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 16,525€ e ndikuar nga lëvizjet buxhetore sipas vendimeve për transfere. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 59.4%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 8,239,791€. Rritja ishte ndikuar nga lëvizjet buxhetore sipas vendimeve për transfere në mes në kategorive ekonomike në vlerë 1,296,088€, vendimeve të Qeverisë në vlerë 6,932,639€, dhe ndarjet nga grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë 11,064€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 91%;
- Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 15,308,834€ si rezultat i kërkesave për transfere dhe vendimeve të Qeverisë në vlerë 15,303,834€ dhe ndarjet nga grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë 5,000€. Shpenzimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 61%. Ky nivel i ulët i realizimit ishte si rezultat i mos fillimit/zbatimit të procedurave të prokurimit për projekte kapitale, anulimit të procedurave si dhe mos inicimit të kërkesave nga njësitë kërkuuese.

Disa nga projektet që kanë ndikuar në realizimin e ulët të buxhetit ishin:

- Kompleksi memorial „Adem Jashari " Prekaz- Skenderaj, në shumë prej 2,000,000€. Projekti është ri-tenderuar dhe për shkak të ankesave të operatorëve ekonomikë, lënda ka qëndruar për disa muaj në OSHP. Kontrata është nënshkruar në gusht 2024, por për shkak të dinamikës së ulët të punimeve në terren, mjetet kanë mbetur suficit;
- Teatri dhe Opera Dr. Ibrahim Rugova, me muaj të tërë lënda ishte në OSHP. Kontrata në vlerë 2,700,000€ është lidhur në fillim të muajit janar 2025, dhe për rrjedhojë e gjithë shuma ka mbetur suficit;
- Renovimi i Stadiumit “Adem Jashari” Mitrovicë, për shkak të dinamika së ulët të punimeve në terren, pjesa e buxheti të projektit prej 1,724,757€ ka mbetur në suficit;
- Renovimi i Stadiumit të Qytetit në Gjilan në shumë prej 5,000,000€ ka dështuar në fazën e prokurimit dy herë gjatë vitit 2024;
- Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit në Pejë në shumën prej 1,500,000€, nuk është realizuar në vitin 2024, pasi që procesi ishte në rivlerësim të dosjeve, sipas Vendimit të OSHP-së;
- Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Ferizaj në shumë prej 1,500,000€, ishte në proces të rivlerësim të tenderit, sipas Vendimit të OSHP;
- Ndërtimi i Qendrës Nacionale të Xhudos, Pejë në shumë prej 2,500,000€ ka dështuar në fazën e tenderimit (sipas komisionit vlerësues s’ka pas ofertë të përgjegjshme) etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga MKRS në 2024 ishin në vlerë 78,929€. Këto të hyra janë realizuar kryesisht nga: taksat administrative, participimet dhe të hyrat nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	113,426	113,426	78,929	88,847	139,703
Të hyrat jo tatimore	113,426	113,426	51,648	65,999	54,077
Të hyrat tjera	0	0	27,281	22,848	85,625

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka rezultuar me 13 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar ndërsa shtatë (7) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë se, projektet e financuara për komuna për të cilat janë bërë pranimet teknike, përmes procedurave formale, të bëj bartjen e pronësisë dhe në të njëjtën kohë t'i largoj ato nga regjistrat e pasurisë së ministrisë. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet regjistrimi i pasurive kapitale me qëllim të ruajtjes së pasurisë dhe paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PFV.	Situatë e ngjashme është evidentuar edhe gjatë vitit 2024.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuata, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar raste të keqklasifikimit të pagesave të cilat kanë ndikuar në prezantimin e drejtë të shpenzimeve në PFV.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për opinion	Ministri përmes zyrtarëve përkatës duhet të forcojë kontrollet dhe duhet të sigurojë që vlerat financiare të pagesave dhe pranimeve, të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV.	MKRS ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë që po zbatohen kontrollet e duhura me rastin e aplikimit të procedurave të prokurimit, respektimin e dispozitave ligjore që garantojnë konkurrencën, dhe po bëhet ekzekutimi i kushteve të pagesës të parapara sipas llojit të kontratave, në mënyrë që të mos krijohen shpenzime përtej planifikimit dhe limiteve të lejuara. Po ashtu, planifikimi i prokurimit të bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të prokurimit, departamentin e buxhetit dhe njësisë kërkuese, në mënyrë që të bëhet një planifikim i duhur i procedurave për të siguruar vlerën për para.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se ekzistojnë mekanizma të duhur për të siguruar se për çdo mbështetje financiare lidhet kontrata me përfituesin në përputhje me kërkesat ligjore në mënyrë që të arrihen objektivat e synuara.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha projektet e subvencionuara arsyetohen në kohën e paraparë dhe të jenë konform kërkesave të memorandumit, mbështetur me dokumente valide të parapara me rregulloren për subvencione dhe transfere. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar raste të ngjashme të vonesave në arsyetimin e subvencioneve.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat të procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit, njëherit edhe raportimi i tyre në Thesar të bëhet i plotë dhe në baza periodike të parapara me rregulla financiare.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar raste të ngjashme të vonesave në pagesën e obligimeve.	Nuk ka filluar zbatimi

8.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pasqepnuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar raste të ngjashme.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës në procese të tenderimit të kërkojë zbatim të plotë të procedurave dhe kërkesave për çdo kontratë publike të nënshkruar bazuar në kërkesat ligjore.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
10.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë se procesi i vlerësimit të projekteve për subvencionim bëhet në përputhje me afatet kohore të parapara sipas rregullores për subvencionim, dhe në bazë të kriterëve të parapara në thirrjet publike. Po ashtu, të sigurojë që kriteret e vendosura në thirrje publike aplikohen në tërësi dhe që kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike.	Nuk kemi hasur raste të tilla nga testimi i mostrave.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonësive/shkëputjeve të kontratave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar raste raste të vonësive në realizimin e punimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se themelohen komisionet përkatëse dhe bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, ZKA duhet të analizojë nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë për shkak të shtrirjes së gjerë të insitucioneve vartëse në kuadër të MKRS.	MKRS ka ndërmarrë masa për zbatim të këtij rekomandimi,	I zbatuar
13.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se aplikohet sistemi i regjistrimit të pasurive jo-kapitale në sistemin e-pasuria me qëllim të ruajtjes së pasurisë dhe paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PFV. Po ashtu, njësitë vartëse të plotësojnë pozitat me zyrtarë të pasurisë dhe të njëjtit të trajnohen për përdorimin e sistemit e-pasuria.	Janë evidentuar raste të ngjashme të mos regjistrimit të pasurisë.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Arian Haxha, Udhëheqës i ekipit




Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



Shemsije Llugiqi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mangësi në proceset e rekrutimit	Në lidhje me proceurën e rukrutimit në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (ASHAK), është jo kontestuese se thirrja e konkursit në aktin nënligjor jo adekuat ka qenë e gabuar dhe rrjedhimisht aspekteve procedurale si : afatet e aplikimit kanë qenë të ndryshme nga sa përcsakton akti nënligjor adekuat - Rregullorja (QRK) Nr.15/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimin për Nënpunësit Administrativ Teknik - akti nënligjor i zbatueshëm në kohën e hapjes së këtij konkursi si dhe kriteri i vendosur në konkurs, ka qenë gabim teknik kur për këtë kategori të nënpunësve është kërkuar përvojë e punës prej 3 viteve, pavarsisht se kërkesat e aktit juridik të përgjithshëm nuk parashohin një kohëzgjatje të tillë të përvojës. Në këtë drejtim, gabimet nuk kanë pasur efekt material në zbatim sepse veprimet faktike janë në përputhje me dispozitat materiale për çështjen e njëjtë. Propozimi ynë do të ishte që të riformulohet përmbajtësisht e gjetura asthu që të reflektojë aspektet formale dhe procedurale të lëshimeve gjatë ekzekutimit.	E gjetura mbetet e pandryshuar, pasi që kriteret e vendosura në konkurs publik duhet të jenë në përputhje me rregulloren përkatëse, dhe në rastet kur kriteret janë vendosur gabimisht në konkurs do të duhej të anulohet konkursi.
Tejkalimi i buxhetit të planifikuar dhe subvencionim i paplanifikuar	Thirrjet publike sipas vlerësimit të komisioneve vlerësuese kanë rezultuar me projekte kualitative të cilat kërkojnë mbështetje substanciale për të arritur qëllimin e projektit të propozuar. MKRS pasi ka krijuar kushtet financiare, duke proceduar në tërësi disponueshmërinë e mjeteve brenda kodeve përkatëse për mbështetjen e skenës së pavarur kulturore, përmes	E gjetura mbetet e pandryshuar, është konfirmuar edhe nga MKRS që kishte tejkalim të kufizimeve buxhetore të vendosura në thirrjen publike. Për më tepër, nuk është ofruar ndonjë dëshmi sa i përket kërkesës për buxhet shtesë dhe aprovimeve përkatëse. Sa i përket subvencionimit të RTK-së, rregulloret përkatëse për

	plotësim - ndryshimit të vendimeve ka aprovuar buxhetin e ri për mbështetjen. Rrjedhimisht buxheti i mbështetjese nuk është tejkaluar, por mbi bazën e vlerësimit të komisioneve profesionale të MKRS-së është ndryshuar Mendojmë se kjo çështje duhet të analizohet në dimensionin e planifikimit për qka mund të punohet më shumë në parashikimin më të përafërt të kufijve buxhetorë. Ndërsa sa i përket dispozitave ligjore dhe nënligjore, konsiderojmë se rritja e buxhetit është bërë në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore të parashikuara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe kjo vendimmarrje është bazuar në pranimin e projekt propozimeve në numër dhe cilësi më të madhe se sa parashikimet të cilat projekt propozime përmbajtësht kanë adresuar politikat e MKRS-së. Sa i përket marrveshjeve me RTK-në konsiderojmë se nuk mund të qëndrojë kjo e gjetur për arsye se qëllimi i marrëveshjes nuk ka qenë financimi i RTK-së, por adresimi i komponentës së promovimit në kuadër të politikave të miratuara të MKRS-së. Sqarojmë parimisht se MKRS, promovimin në fushën e kulturës, trashigimisë kulturore, sportit, rinisë dhe të drejtës së autorit e ka dimension të rëndësishëm të politikave dhe objektivave prandaj synimi që të arrihen këto objektiva, nuk është në kundërshtim me rregullat e financimit publik të transmetuesit publik apo të shpenzimit të parasë publike.	subvencionim nuk parashohin subvencionim për institucione publike.
--	---	---

Vonesat në arsyetimin e subvencioneve	Federatat kanë bërë kërkesa për zgjatje të periudhës së zbatimit të aktiviteteve të projektit, dhe kanë dorëzuar dosjet e projektit të cilat kanë kërkuar plotësime për të siguruar rregullsinë e raportimit në shfrytëzimin e parasë publike. Qe te dyja rastet procesi i verifikimit ka perfunduar ne muajin x të vitit 2024 dhe raportet janë aprovuar nga zyrtarët përgjegjës.	E gjetura mbetet e pandryshuar, për faktin që MKRS nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar se Federatave ju është zgjatur afati për zbatim të aktiviteteve të projektit.
Formimi i komisionit vlerësues dhe i ankesave për subvencionet jo në përputhje me kërkesat ligjore	Komisioni i vlerësimit të projekteve të "Fondit të mobilitetit" për OJQ dhe komisioni i ankesave për OJQ nuk kanë asnjë antarë të njëjtë. Komisioni i vlerësimit të projekteve të "Fondit të Mobilitetit" për Individ dhe komisioni i ankesave për OJQ shqyrtojnë kategori të ndryshme të aplikimeve dhe rrjedhimisht nuk përbën asnjë konflikt të interesit. Ndërsa Komisioni i vlerësimit për projektet e OJQ-ve ka pasur përfaqësues nga sektori i kulturës, përkatësht i TKK si institucion i kulturës, dhe zyrtarit për kulturë nga MKRS-së zyra në Prizren.	E gjetura mbetet e pandryshuar, pasi MKRS nuk ka ofruar asnjë dëshmi që vërteton të kundërtën. Në komisionin e vlerësimit dhe komisionin e ankesave për vlerësimin e projekteve për "Fondin e Mobilitetit" për OJQ, në të dyja komisionet është angazhuar i njëjti zyrtar (vendimi 751/2024 dt. 13.05.2024, dhe vendimi 928/2024 dt. 14.06.2024). Ndërsa te thirrja publike për projekt - propozimet në fushën e artit, kulturës dhe trashigimisë kulturore për vitin 2024, në komisionet vlerësuese për OJQ dhe për individ, nuk ka asnjë zyrtar nga departmenti i kulturës dhe përfaqësues nga divizionet për buxhet dhe financa.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/ DATUM/ DATUM: 27-05-2025			
Nr. Prot.	Nr. Prot.	Nr. Prot.	Nr. Prot.
03	47	803	8



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT	
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE	
DATE/ DATUM/ DATUM: 27-05-2025	
Nr. Prot.	Nr. Prot.
01	02
274812025	
27/05/2025	
Pratime	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport - Ministry of Culture, Youth and Sport

LETËR E KONFIRMIMIT

Për kryesisht pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet në pjesën ku kemi komente të njëjtat mund t'i gjeni në shtojcën e komenteve.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në detyrë

Data: 26.05.2025, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁰, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Renovimi i stadiumeve ekzistuese të futbollit në qendrat regjionale, 363,636€; Revitalizimi i qytetit të vjetër të Janjevës, 245,380€; Shpronësimi i pronës në k.m "Masakra e Reçakut" Reçak- Shtime, 109,961€; Objektet kulturore (renovimi), 101,867€; Renovimi i stadiumit Adem Jashari - Mitrovice 29,916€; Pasuritë e pa prekshme (digjitalizimi), 20,000€; Paisje tjera, 56,315€.
- ⁶ Renovimi i objekteve kulturore, vlera e pagesës 47,042€; Qendra rinore Deçan, vlera e pagesës 13,065€, Lagjja e Hajdineve ne Terziaj Gjilan, vlera e pagesës 55,771€.
- ⁷ 1) Kontrata për "Punët ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm të arkitekturës dhe inxhinierisë për zgjerimin dhe renovimin e Stadiumit të Qytetit në Shtime - Ri tenderim" me vlerë 2,946,757, gjatë hartimit të specifikave teknike kishte përdorur Marka-Brende të produkteve specifike siq ishte në rastin "Instalimet e Makinerisë keni specifikuar në pozicionin 1 "Radiatori të çelikut të "Fabrikës së Radiatorëve" Gjilan. Qmimi per njesi 200€. 2) Kontrata për "Furnizim me pajisje pune dhe materiale të nevojshme për restaurim - konservimin e artefakteve dhe kabineteve për Muzeun Kombëtar të Kosovës Ritenderim i dytë" me vlerë 64,915€, pozicioni nr 6 Thithse(fshesë) pluhuri për pastrim sipërfaqësor të artefakteve vlera 250€.
- ⁸ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.